



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Pemëtari - Vreshtari

Programi: Pemëtari dhe Vreshtari

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Arbenita Aliu, me titull:
”Ndikimi i mikorizës te mjedra në kushte të serrës – kultivari Endrosadira”

ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 18.02.2025 deri me datë 24.03.2025.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Bedri Dragusha kryetar
2. Prof. asoc. Vahid Avdiu mentor - anëtar,
3. Prof. ass. Muhamet Zogaj, anëtar

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonte te udhëheqësi shkencor i temës Prof. asoc. Vahid Avdiu, përmes e-mail adresës vahid.avdiu@uni-pr.edu.

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji është i mirëseardhur dhe mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

DEPARTAMENTI PEMËTARI -VRESHTARI

PROGRAMI PEMËTARI DHE VRESHTARI



PUNIM I DIPLOMËS MASTER

**NDIKIMI I MIKORIZËS TE MJEDRA NË KUSHTE TË SERRËS – KULTIVARI
ENDROSADIRA**

Mentor:

Prof. asoc. Dr. Vahid Avdiu

Kandidati:

Bsc. Arbenita Aliu

Prishtinë, 2025

ABSTRAKTI

Studimi mbi kulturën e mjedrës është kryer gjatë vitit 2024, në fshatin Dyz, Komuna e Podujevës në një serrë me sipërfaqe 0.3 pronë familjare në emër të kompanisë “Dyzi Berry fruits”. Mjedra (*Rubis ideus* L.) është një kulturë pemëtare që bënë pjesë në grupin e pemëve të imëta, nuk ka kërkesa specifike për kultivim. Mjedra është një prej frutave me vlerat mjaft të larta ushqyese dhe tregtare. Për shkak të përdorimit të shumanshëm kërkesat për fruta të mjedrës po rriten vazhdimisht. Nga kjo rrjedhë se zbatimi i teknologjive të reja me qëllim të rritjes së rendimenti dhe cilësisë së frutave si dhe rritjes së periudhës së mbulimit të tregut me fruta të freskëta, është një sfidë dhe interes i veçantë. Përhapja e kulturës së mjedrës, që po ndodhë viteve të fundit në vendin tone por edhe në vendet tjera, ka ngritur shumë pyetje rreth tejkalimit të pengesave dhe gjetjes së formës me të përshtatshme të kultivimit, që të kemi një rendiment dhe cilësi sa më të lartë për njësi të sipërfaqes. Në rastin tonë është hulumtuar kultivari i mjedrës Enrosadira me veti rilulëzuese, që mund të japë fruta në lastarë njëvjeçar dhe dyvjeçar. Gjatë hulumtimit janë përdorur tre tretmanë me mikorizë (Myco Apply, Nutria Bio Nutria Bio + Trichowel) dhe një pa mikorizë – kontrollë. Për secilin tretmanë për hulumtim janë marrë nga 3 përsëritje me nga një metër gjatësi (3 bimë për metër gjatësi). Në studim janë përfshi hulumtimi i parametrave biologjik, morfologjik, pomologjik, prodhues dhe biokimik. Nga rezultatet e fituara është konstatuar se janë shfaqur ndryshime të konsiderueshme në mes të varianteve të testuar. Në rastin konkret tretmanët me mikorizë (Myco Apply, Nutria Bio, Nutria Bio + Trichowel) kanë dhënë rezultate mjaft të rëndësishme dhe një ndryshim të madh si në rendiment ashtu edhe në cilësi të frutave në raport me tretmanin pa trajtim.

Fjalët kyçe: mjedra, Enrosadira, mikoriza, parametrat biomorfologjik